

GJYKATA THEMELORE NË P. –Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia –Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit Kompania e Sigurimit “S.“ sh.a. me seli në P., të cilën e përfaqëson me autorizim A. Sh. nga P., kundër të të paditurës Kompania e Sigurimit “K. e R.”me seli në P., për rimbursimin e borxhit, vlera e kontestit 2,075.00 euro, në seancën e mbajtur me datën;26.05.2016,në prani të palës paditëse dhe në mungesë të të paditurës,ndërsa me datën 03.06.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K.S “S.“ sh.a. me seli në P. dhe DETYROHET Kompania e Sigurimit “K. e R.” , me seli në P. që paditësit t’ia kompensojë shumën prej 2.075.00 euro (dy mijë e shtatëdhjetë e pesë euro),në emër rimbursimit të borxhit, me kamatë ligjore prej 12% duke u llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë me dt.30.09.2015, e deri në pagesën definitive,të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

II.DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguaj shumën prej 250.00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi KS”S.” sh.a. me seli në P., me datën 30.09.2015, ka paraqitur padi për rimbursimin e borxhit në shumë prej 2,543.88 euro, kundër të paditurit K.S. “K. e R.”–me seli në P. me kamatë prej 12% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, njëherit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Lidhur me këtë çështje juridike Gjykata duke u bazuar në nenin 423 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës mbajti seancën kryesore,në mungesë të të paditurit me propozimin e paditësit, pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt me çka u vërtetua nga fletëkthesa e cila gjindet në shkresat e lëndës, por mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

I autorizuari i paditësit pas marrjes së ekspertizës për vlerësimin e dëmit ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 2,075.00 euro, duke mbetur pranë të gjitha pretendimeve të tij në padi po ashtu ka shtuar se baza juridike e kërkesëpadisë buron nga kontrata me nr.2330 dt.23.11.2011 si dhe vazhdimin e kontratës dt.22.11.2012 për sigurimin e automjeteve të policisë së Kosovës në mes të operatorit ekonomik dhe Policisë së Kosovës po ashtu baza juridike është vërtetuar edhe nga ekspertiza e komunikacionit dhe ka propozuar që kërkespadia e paditës të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i paditurit përmes përgjegjies në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkespadin e paditësi si për nga baza ashtu edhe nga lartësia për faktin se nuk ka ekspertizë të komunikacioni apo aktgjykim penal me të cilën do të vërtetohet fajësia apo pafajësia e shkaktarit.

Lidhur me këtë çështje juridike gjykata ka bërë administrimin e provave, si në vijim: kontrata me nr.214/11/57/211 nr.potokolit 233 dt.29.11.2011, vazhdimi i kontratës dt.23.11.2011, paraqitja e dëmit pa datë, urdhërpagesë e dt. 24.12.2014, raporti policor i dt.15.11.2014, dorëzimi i servisit dt.01.12.2014, fatura me nr.595-14 dt.23.12.2014, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit dt.02.12.2014, dorëzimi i dokumenteve në kompanin e sigurimeve “S.” dt.02.12.2014, libreza e veturës së dëmtuar me targa *numri i targave...*, raporti i oficerit dt.15.11.2014, kallëzimi penal dt.21.11.2014, fotodokumentacionet, polisa e sigurimit nr.0004926398 e lëshuar nga K.S.”S.”, polisa e sigurimit nr.0005090954 e lëshuar nga K.S.”K. e R.” dt.06.05.2014, libreza e veturës së shkaktarit “Opel” me nr. Të rregjistrimit *numri i targave...*, procesverbali mbi ekzaminimin e alkoolit në organizëm, deklarata e vozitësit B. Sh. dt.15.11.2014, deklarata e drejtuesit Y. G. dt.15.11.2014, ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti Sejdi Berisha dt.20.04.2016, ekspertiza e makinerisë i punuar nga i njejt ekspert e dt.21.04.2016.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit të kujdesshëm të tyre, secilës veç e veç dhe të gjithave së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, si dhe nga konstatimi i faktete jo kontestuese në mes të palëve në procedurë, gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike:

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacioni Sejdi Berisha, të dhënë ekspertizën e datës 20.04.2016, nga e cila është vërtetuar se shkaktar i aksidentit është automjeti Opel, tipi Meiva me targa *numri i targave...* i siguruar te i padituri, i cili si pasojë e lëshimeve teknike nga ana e ngasësit të automjetit, ku ky ngasës ka lëvizur me shpejtësi të madhe rreth 100km/h në vendin ku shpejtësia është e kufizuar në 80(km/h) dhe nuk e ka respektuar distancën e sigurisë.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit për vlerësimin e dëmit material Sejdi Berisha të dhënë në ekspertizën e datës 21.04.2016, u vërtetua se vlera e dëmit material e automjetit të siguruar të paditësit, Toyota Land Cruiser, me targa *numri i targave...* është në shumë prej 2,075.00 euro, vlerë kjo e përcaktuar duke u bazuar në çmimet e pjesëve të automjetit të cilat janë ndërruar dhe të cilat janë llogaritur sipas serviseve të autorizuar.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat e lartëcekura si dhe duke iu referuar nenit 960 të LMD-së, me të cilën është përcaktuar se me pagimin e kompensimit, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilëndo bazë qoftë është përgjegjës për dëmin, nga sigurimi kalojnë në siguruesin. Gjithashtu edhe instituti i sigurimit nga autopërgjegjësia është institut i instaluar pikërisht për mbrojtjen e të dëmtuarve, e kjo parashihet qartë në nenin 960 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit si dhe me nenin 25 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dispozitat e të cilave nuk bëjnë përjashtime nga fakti se a është automjeti i mbuluar me sigurim kasko apo jo, gjegjësisht obligimin e të dëmtuarit që lidhur me aksidentin detyrimisht rastin t’ia paraqet kompanisë së sigurimit pranë së cilës është i siguruar automjeti i shkaktarit të aksidentit.

Përkundrazi neni 921 i LMD-së shprehimisht parasheh se palët me kontratë nuk mund të parashohin dicka me të cilën palës së dëmtuar mund ti mohohet e drejta e kompensimit të dëmit nga baza e sigurimit nga autopërgjegjësia.

Gjykata po ashtu ka gjetur se e paditura mban përgjegjësi lidhur me kompensimin e personit të tretë, përkatësisht të paditësit për arsye se aksidenti është shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit të siguruar te e paditura, dhe se dëmi i cili i është shkaktuar paditësit qëndron në lidhje kauzale me veprimet e të siguruarit të të paditurës, respektivisht dëmi është shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së saj, e cila duke mos ia përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave tjera në rrugë, ka shkaktuar edhe aksidentin e trafikut, nga i cili ka pësuar dëme materiale automjeti të cilin e ka drejtuar i siguruari i paditësit.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia për rimbursimin e mjeteve të paguara në emër të sigurimit është e bazuar dhe rrjedhimisht gjykata e aprovoi atë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Lartësinë e shumës për dëmin material në shumë prej 2,075.00 euro, gjykata e përcaktoi në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit për vlerësimin e dëmit Sejdi Berisha, të dhënë në Ekspertizën e datës 21.04.2016, të cilës ia fali besimin plotësisht pasiqë i njëjti lartësinë e shumës për dëmin material e kishte përcaktuar duke u nisur nga pjesët e dëmtuara të automjetit, në bazë të hulumtimit të çmimeve të pjesëve të këmbimit në treg.

Meqenëse e paditura me pagesën e borxhit ka rënë në vonesë, gjykata e detyron të paditurën që në shumën e gjykuar, në vështrim të dispozitës së nenit 26 paragrafi 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, paditësit t'ia paguajë kamatën vjetore në lartësi prej 12%, ashtu si është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga pala paditëse dhe atë: për pagesën e taksës për padi shumën prej 25.00 euro, 2 (dy) ekspertiza gjyqësore në shumën prej 200.00 euro; taksën për aktgjykim shumën prej 25.00 euro, e të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 250.00 euro.

Nga e tëra që është cekur më lartë është vendosur si në diapozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 423 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË P.
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.C.nr.423/15 me datë 03.06.2016

Gjyqtarja,
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në P. përmes kësaj gjykate.